



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhë Praktike (Moduli 1)

Ngarkesa: 8 kredite; 80 orë seminare;

Viti / Semestri: Viti I/ Semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në “Përkthim dhe Interpretim në gjuhë ruse “

Kodi i lëndës:Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

Adresa elektronike e titullarit/e e pedagogut të lëndës:Elvira.xhamani@unitir.edu.al;

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Lënda bën përshtatjen kulturore dhe gjuhësore të studentëve, përgatitjen për formimin bazë të njohjes me gjuhën ruse. Praktika e gjuhës është një proces aktiv krijues i shoqëruar nga një aktivitet praktik. Praktikimi i gjuhës fillon me formimin e seancës fonetike dhe asaj të intonacionit. Aftësitë e qarta dhe të sakta të shqiptimit janë një nga kushtet kryesore për të lehtësuar procesin e perceptimit dhe të folurës korrekte të një gjuhe.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të ritregojë teksin me një farë modifikimi.
2. Gjatë dëgjimit, si formë gojore riprodhuese e veprimtarisë gjuhësore, duhet të arrijë të kuptojë me të dëgjuar replika të veçanta dhe ligjëratë të ndërtuar në bazë të materialit të njohur.
3. Të dëgjojë e plotësoj ushtrime pa ndihmën e mjeteve vizive.
4. Të marrë informacion nga një tekst i dëgjuar në audiokasetë dhe ta ritregojë atë shkurtimisht.
5. Të arrijë të kapë kuptimin kryesor të një teksti të dëgjuar, pa u përpjekur të kuptojë çdo fjalë, si dhe të shkruajë çfarë mban mend nga ai tek

Rezultatet e pritshme :

1. Zhvillojë aftësi të kuptimit dhe të prodhimit të të folurit dhe të dëgjimit, përmes situatave të thjeshta komunikative në gjuhën e synuar.
2. Zbatojë kompetencën njëgjuhësore në mënyrë funksionale, duke ndërtuar fjali të sakta dhe të kuptueshme për situata të përditshme.
3. Ndërtojë dialogë dhe të përgjigjet në mënyrë të përshtatshme ndaj pyetjeve të thjeshta, në kontekste të zakonshme si familja, mjedisi, miqtë apo jeta personale.